



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 tetor 2011
Nr. ref.: RK 142/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 19/11

Parashtruesi

L. H.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, C. nr.
271/10, të 7.10.2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është L. H.
Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar që Gjykata duhet të marrë parasysh mbrojtjen e identitetit të saj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutë është Vendimi i Gjykatës Komunale në Pejë, CI. nr. 271/10, i datës 07.10.2010.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës më 18 shkurt 2011 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, CI. nr. 271/10, të datës 07.10.2010, me ç'rast versioni në gjuhën serbe është nxjerrë më 07.10.2010, por pala nuk e ka saktësuar kur e ka marrë atë dhe, më pas, pala pranoi se versionin në gjuhën shqipe të cilin e ka marrë më 30 maj 2011.

Shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

4. Parashtruesi pretendon se Vendimi i Gjykatës Komunale në Pejë, i nxjerrë në gjuhën serbe, në të cilin deklaronte se nuk është kompetente për të vendosur për padinë e saj, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht me nenin 24.1 (Barazia para Ligjit).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2009, që hyri në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Kërkesa e parashtruesit

6. Parashtruesi i ankesës pohon se Gjykata Komunale në Pejë, duke u shpallur se nuk është kompetente për të vendosur për padinë e saj për ndryshimin e Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. 367/09 lidhur me realizimin e të drejtës për kujdes prindëror ndaj vajzës së saj, sipas kushteve të cekura në Vendim, dhe duke e udhëzuar gabimisht për organin kompetent për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike, e ka vënë atë në pozitë të pabarabartë me ish-bashkëshortin e saj, i cili gjoja abuzon me të drejtat e saj siç përcaktohet në Vendimin e sipërpërmendur, dhe në këtë mënyrë shkeli të drejtën e garantuar me Kushtetutë, respektivisht me nenin 24 të Kushtetutës.

Procedura në Gjykatë

7. Më 18 shkurt 2011, Gjykata Kushtetuese e pranoi kërkesën e parashtrueses dhe e regjistroi atë nën nr. KI 19/11.
8. Më 2 mars 2011, me vendimin GJ. R 19/11, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues.
9. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin KSH 19/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović, kryesues, dhe Kadri Kryeziu e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë të Kolegjit.
10. Më 4 maj 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Komunale dhe Gjykatën e Qarkut në Pejë, si dhe parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e lëndës.

11. Më 20 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese pranoi dokumentacion shtesë nga parashtruesja.
12. Më 19 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese pranoi një përgjigjeje njëfletëshe nga Gjykata Komunale në Pejë lidhur me datën kur Vendimi i kësaj Gjykate, C. nr. 271/10, i ishte dorëzuar parashtrueses.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 24 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Vendimin C nr. 367/09 me të cilin e kishte ZGJIDHUR (shkëputur) martesën (me MARËVESHJE) e lidhur ndërmjet K. M. nga fshati Llabjan, komuna e Pejës, dhe L. M. nga Drenasi.
14. Në bazë të këtij Vendimi, fëmija i E. M. i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim babait K. M.
15. Sipas këtij Vendimi, Gjykata kishte VENDOSUR për kontaktet e znj. L. H. (nëna) me fëmijën e saj – vajzën E.- çdo të dytën dhe të katërtën të premte të muajit dhe do të qëndronte me të deri të dielën në orën 17:00. Sipas këtij Vendimi, znj. L. H. obligohej t'ia kthente fëmijën e mitur – vajzën E. - babait të saj në vendin ku e kishte marrë. Gjykata e kishte marrë këtë vendim duke u bazuar në marrëveshjen paraprake të palëve të arritur më 24.09.2009, të nënshkruar nga z. Rexhep Kaçaniku, përfaqësues ligjor i K. M. dhe L. H.
16. Sipas Vendimit të sipërpërmendur, parashtruesja, L. H., gjithashtu ka të drejtë që gjatë pushimit dimëror ta marrë vajzën E. në kohëzgjatje prej 8 (tetë) ditëve dhe gjatë pushimeve verore në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.
17. Më 11 dhjetor 2009, duke parë që z. K. M., ish-bashkëshorti i saj, nuk po i përmbahej Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, C. nr. 367/09, lidhur me kontaktet e nënës me fëmijën, znj. L. H. dorëzoi një propozim në Gjykatën Komunale në Pejë me anë të të cilit kërkonte zbatimin e lejes për të kontaktuar dhe për t'u kujdesur për vajzën e saj sipas kushteve të përcaktuara në Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, me të cilin ishte zgjidhur martesa e saj me ish-bashkëshortin e saj z. K. M.
18. Më 12 mars 2010, Gjykata Komunale në Pejë mbajti seancën për zbatimin e Vendimit E. nr 593/09 (i cili mungon në shkresat e lëndës) me të cilin rast debitori z. K. M. deklaroi se ai vullnetarisht do ta bëjë ekzekutimin e këtij Vendimi dhe se debitoja, znj. L. H., do të mund të shkonte menjëherë në qendrën për punë sociale në Pejë ku ishte duke qëndruar vajza e tyre E. dhe se ai kishte vepruar në të njëjtën mënyrë dy javë më parë. Në këtë rast Gjykata Komunale e ka ZBATUAR në tërësi ekzekutimin e Vendimit duke u bazuar në titullin ekzekutiv.
19. Më 7 maj 2010, znj. L. H., Pejë, ka parashtruar PADI për NDRYSHIMIN e Vendimit C. nr. 367/07, me të cilin ishte zgjidhur martesa e saj me ish-bashkëshortin e saj dhe kishte vendosur për “mbajtjen, kujdesin dhe edukimin e vajzës së tyre dhe mënyrat e kontaktit ndërmjet nënës dhe vajzës së saj”, sepse ajo ishte e pakënaqur me gjendjen ekzistuese duke e konsideruar veten si palë të dëmtuar dhe të pabarabartë, sepse ajo çdo herë duhej të shkonte në Qendrën për punë sociale në Pejë për ta marrë vajzën e vet ë dhe jo që ish-bashkëshorti i saj t'ia sillte vajzën në Drenas, dhe duke theksuar se kjo i kushtonte në kohë dhe para pasi ishte e punësuar.
20. Më 7 tetor 2010, Gjykata Komunale në Pejë me VENDIMIN P. br. 271/10, të përpiluar dhe dërguar parashtrueses vetëm në gjuhën serbe, e shpalli veten jokompetente për të vendosur për këtë çështje juridike duke udhëzuar palën që t'i

drejtohet Institucionit të Qendrës Sociale në Pejë, i cili, sipas Gjykatës, është kompetent për të vendosur në këtë kontest.

21. Në këshillën juridike ishte shkruar se pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Znj. L. H. nuk kishte ushtruar ankesë kundër këtij vendimi në gjuhën serbe në afat prej 15 ditësh. Në formularin e Gjykatës Kushtetuese, ajo deklaroi se nuk kishte ushtruar ankesë sepse nuk e kuptonte gjuhën serbe.
22. Më 5 nëntor 2010, Qendra për Punë Sociale në Pejë, nëpërmjet Raportit të Nëpunësit Social nr. 1085.07.2009, iu përgjigj Gjykatës Komunale në Pejë se sipas ligjit në fuqi (Ligji i Kosovës për familjen Nr. 2004/32) nenet 139-145, si dhe në përputhje me qarkoren e Departamentit për Mirëqenie Sociale nr. 1020, të 25 majit 2010, qendrat për punë sociale nuk janë kompetente për të nxjerrë vendime lidhur me “kujdestarinë e fëmijëve, kontaktet e fëmijëve me njërin prind apo për çështje të alimentacionit” sepse këto janë çështje të përcaktuara në mënyrë ligjore e të qartë.
23. Më 20 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese mori dokumente shtesë nga znj. L. H., që në fakt ishte një letër e shkruar me dorë në të cilën shpjegonte kërkesën e saj të paraqitur në këtë Gjykatë më 18 shkurt 2011. Në deklaratë, ajo pranoi se e kishte marrë Vendimin P. br. 271/10, të 7 tetorit 2010, nga Gjykata Komunale në Pejë dhe se ai ishte edhe në gjuhën shqipe. Ajo nuk theksoi kur e kishte marrë atë vendim në gjuhën shqipe.
24. Më 19 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese mori një dokument shtesë si përgjigje nga Gjykata Komunale në Pejë, e cila konfirmoi se znj. L. H. e kishte marrë Vendimin C. 271/10 të Gjykatës Komunale në Pejë, të përkthyer në gjuhën shqipe, më 30 maj 2011. Ajo nuk ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në versionin në gjuhën shqipe në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi më 30 maj 2011.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
27. Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, i cili thotë:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

 - a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar.
28. Absolutisht nuk është e qartë kur parashtruesja e mori vendimin e Gjykatës Komunale në Pejë në gjuhën shqipe. Nëse parashtruesja e mori Vendimin në shqip nr. P. br. 271/10, të Gjykatës Komunale në Pejë, më 7 tetor 2010, apo më 30 maj

2011, siç pohon, është e qartë që ajo nuk ushtroi ankesë brenda 15 ditëve, siç parashihet me ligj, edhe pasi e kishte marrë vendimin më 30 maj 2011, siç pranon.

29. Prandaj, Gjykata thekson se kriteri i shterimit “të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj” është absolutisht i domosdoshëm si kusht themelor për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, dhe përveç që është kusht juridik i paraparë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, ai është përcaktuar si kusht themelor me rregullin 36 pika (a) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.
30. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’ua lejojë autoriteteve, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efikase juridike për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
31. Gjykata kishte zbatuar arsyetim të tillë gjatë shqyrtimeve të mëparshme të kërkesave, si në rastet: KI 55/10 Kërkesa e Hamide Osajt për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, të 4 qershorit 2010; Rasti nr. KI 20/10 Muhamet Bucaliu kundër Aktgjykimit të Prokurorit të Shtetit KMLC.nr. 09/10 të 24 shkurtit 2010 (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i 15 tetorit 2010).
32. Sa u përket pretendimeve të palës se me Vendimin C. nr. 367/09, të datës 24.11.2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, është shkelur neni 24 i Kushtetutës (Barazia para Ligjit) dhe se znj. L. H. është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, Gjykata e di që ky vendim është nxjerrë në bazë të marrëveshjes së plotë të palëve dhe se edhe kujdesi prindëror, mbajtja dhe edukimi i fëmijës së tyre ishte vendosur sipas marrëveshjes paraprake, të lidhur vullnetarisht, si dhe të nënshkruar nga të dy palët e marrëveshjes. Gjykata Komunale në Pejë vetëm e miratoi marrëveshjen e palëve të përfshira dhe me këtë rast e legjitimoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
33. Gjykata, gjithashtu pranon që parashtruesja mund ta përtërijë kërkesën e vet për t’i ndryshuar termet dhe kushtet e marrëveshjes për kujdes me babanë e vajzës në çfarëdo kohe derisa vajza e saj është ende e mitur dhe pas tregimit të ndryshimit të rrethanave lidhur me fëmijën dhe/ose prindërit. Asgjë nuk e pengon atë apo babanë e vajzës për ta përtërirë kërkesën e saj për ndryshim të këtij Vendimi sipas nenit 150, pika 1 dhe 2 të Ligjit për familjen (Ligji Nr. 2004/32).
34. Pasi zbulimi i identitetit të parashtrueses në këtë rast do të rezultonte edhe në zbulimin e identitetit të fëmijës së mitur të parashtrueses, e cila për shkak të moshës së saj të re dhe të njomë duhet ta ketë identitetin të mbrojtur gjersa rritet dhe e zhvillon identitetin e saj dhe për shkak se vërtet është palë e pafajshme në këtë procedurë, është në interes publik që të mos zbulohet identiteti i parashtrueses, siç kërkohet nga parashtruesja.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 5 tetor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ta miratojë kërkesën e parashtrueses për ta mbrojtur natyrën e konfidencialitetit të identitetit të saj në këtë kërkesë;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani